

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8 dhe neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje me nenin 50 paragrafi 4 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) dhe neni 15 paragrafi 1 alineja 7 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 3 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, e në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5747/5 nga data 21.11.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në mbledhjen e 19-të të mbajtur më 21.11.2014, miratoi

## RREGULLORE PËR MBROJTJEN E PERSONAVE TË MITUR

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Lënda e Rregullores

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra dhe kategorizimi i periudhave të emetimit të programeve audiovizuale që mund të ndikojnë dëmshëm në zhvillimin fizik, psikik dhe moral të personave të mitur, format e paralajmërimit akustik dhe vizual, shenjat vizuale, masat teknike për mbrojtjen e personave të mitur, si dhe mënyra e veprimit me ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale (radiodifuzerët televiziv dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë) me të cilët ndërlihet obligimi për mbrojtjen e personave të mitur.

#### Neni 2 Definicionet

Shprehje të caktuara që janë përdorur në këtë Rregullore e kanë këtë rëndësi:

- **Persona të mitur** janë personat me moshë nën 18 vjet;
- **Programe që mund të ndikojnë dëmshëm mbi personat e mitur** janë tërësitë audiovizuale ose pjesët e tyre përbërëse që përfshijnë përshkrime, skena ose pamje të dhunës, erotikës, sjelljes seksuale të ndaluar me ligj, fjalë të pahijshme (vulgare), forma sugjestive të sjelljes, të lehta për imitacion, kurse të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë, sjellje të ofenduese për dinjitetin e njeriut etj;
- **Dhunë** në kuptim të kësaj Rregullore, është çdo pasqyrim i qartë i çfarëdo forme të kërcënimit që lehtë mund të realizohet me forcë fizike ose përdorim direkt të dhunës, me ose pa armë, forcë që ka për qëllim të dëmtojë ose frikojë një ose më tepër qenie të gjalla. Në këtë drejtim, mund të jetë pasqyrimi i ndonjë dhune të kryer ose qëllimit për dhunë, pa marrë parasysh nëse ajo dhunë mund ose nuk mund të shkaktojë lëndime. Definicioni i këtillë i dhunës përfshinë edhe çfarëdo pasqyrimi të pasojave nga lëndimet fizike të ndonjë qenie të gjallë (ose grupi të qenieve të gjalla), edhe pse nuk është treguar akti i dhunës;
- **Periudhat kohore** janë koha e caktuar e programit gjatë një dite në kuadër të së cilës është lejuar emetimi i programeve të një kategorie të caktuar. Për çdo kategori të programeve ka periudhë të veçantë kohore për emetim;
- **Konteksti programor** në të cilin emetohen përmbajtje të dëmshme për personat e mitur ka të bëjë (por që nuk kufizohet) me: zhanrin e programit; formati i shërbimit programor audiovizuel në kuadër të cilit emetohet programi; periudha kohore e programit dhe renditja e programeve në skemën programore (para dhe gjatë kohës së emetimit të programit konkret) për shërbimet programore televizive; renditja e programeve në katalogun sipas kategorisë për ofruesit e shërbimeve mediatike

audiovizuele me kërkesë; shkalla e dëmit që mund të shkaktohet nga ndonjë përmbajtje programore; numri i pritur dhe përbërja e publikut potencial dhe pritjet e mundshme të publikut; shkalla e pasqyrimin të detajeve për përmbajtjen për të cilën informohet publiku potencial; efektet shtesë që mund ti shkaktojë përmbajtja te shikuesit.

## **II. PËRMBAJTJE QË MUND TË NDIKOJNË DËMSHËM TE PERSONAT E MITUR**

### **Neni 3**

#### **Dhuna**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele janë të obliguar që të mbajnë llogari se pasqyrimi i shpeshtë dhe i vazhdueshëm i dhunës mund të ketë efekt përmbledhës negativ mbi personat e mitur, që mund të shprehet përmes uljes së shkallës së ndjeshmërisë ndaj dhunës dhe përmes zhvillimit të qëndrimit se dhuna mund të paraqesë mënyrë të pranueshme për zgjidhjen e problemeve.

Frika e shkaktuar nga përshkrimet, nga skenat dhe/ose pamjet e dhunës mund të shqetësojë shumë personat e mitur. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele duhet patjetër që gjithmonë me shumë përgjegjësi të kujdesen për baraspeshën në mes të drejtës së publikut të jetë i informuar në kohë dhe saktë, dhe nevojës për mbrojtjen e të miturve.

Skenat me dhunë verbale ose fizike ose me sjellje tjera të dëmshme që lehtë mund të imitohet nga personat e mitur dhe që mund të jetë e dëmshme ose e rrezikshme për ta, nuk guxojnë që të emetohen në programe që janë të dedikuara fillimisht për personat e mitur.

### **Neni 4**

#### **Përdorimi i drogës, substancave psikoaktive, cigareve dhe alkoolit**

Përdorimi i drogës, substancave psikoaktive, cigareve dhe alkoolit, nuk guxon që të emetohet në programet audiovizuele që janë të emetuara kryesisht për personat e mitur.

Në programet audiovizuele të dedikuara për personat e mitur nuk guxon që të përkrahet, nxitet, inkurajohet ose lartësohet përdorimi i drogës, substancave psikoaktive, cigareve dhe alkoolit, përveç nëse ajo nuk arsyetohet përmes kontekstit të zhanrit ose përmes motiveve të veprimit dramatik në program artistik.

### **Neni 5**

#### **Erotika**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele janë të obliguar që të mbajnë llogari se, edhe pse në programe lejohet deri në një kufi të caktuar që të emetohet erotika, përmbajtjet e këtilla, prapëseprapë mund të dëmtojnë personat e mitur. Për këtë arsye kategorizimi i programeve që përmbajnë erotikë duhet patjetër të bëhet në pajtim me përshkrimet e kategorive të përcaktuara në Rregullore.

Kur shtojcat në lajme dhe programe informative përfshijnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që përmbajnë erotikë, vlerësimi për përshtatjen e periudhës për emetimin e tyre në shërbimet programore televizive duhet të bazohen në shkallën eksplicite të detajeve të emetuara.

## Neni 6

### **Sjelljet seksuale, të ndaluara me ligj**

Përpunimi mediatic i temave në lidhje me pedofilinë, keqpërdorimit seksual të të miturve dhe format e tjera të sjelljes seksuale të ndaluar me ligj, mund të arsyetohet vetëm për shkak të së drejtës që publiku të informohet dhe për shkak të problematizimit të tyre më të gjerë shoqëror.

Trajtimi mediatic i temave në lidhje me pedofilinë dhe format e tjera të sjelljes seksuale të ndaluar me ligj, në lajme, programet informative, dokumentare dhe programet e tjera, nuk guxon që të përfshijë çfarëdo sugjerimi ose nxitje të qëndrimit të padëshirueshëm social.

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale janë të obliguar që gjatë kategorizimit të programeve, të mbajnë llogari për atë se përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunimit dhe pasojat e dhunimit mund të kenë pasoja jashtëzakonisht të dëmshme mbi personat e mitur.

Planifikimi i terminit nga ana e radiodifuzerëve televiziv për emetim të programeve, skenari i të cilëve trajton keqpërdorim seksual të personave të mitur, duhet patjetër të bazohet në faktin se personat e mitur mund të shqetësohen si pasojë e identifikimit të pritshëm me viktimën e treguar gjatë aktit të dhunshëm.

Kur shtojcat në lajme dhe programe informative përfshijnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që përmbajnë sjellje seksuale të ndaluar me ligj, vlerësimi për përshtatjen e periudhes për emetimin e tyre duhet të bazohen në shkallën eksplicite të detajeve të emetuara.

## Neni 7

### **Shprehje dhe gjeste të pahijshme**

Përdorimi i shprehjeve dhe gjesteve të pahijshme është e pranueshme në lloje të caktuara të programit argëtues, në programin artistik si element estetik ose gjatë programeve arsimore dhe dokumentare që tematizojnë zbatimin artistik të shprehjeve të pahijshme (vulgare) dhe aspektet e tija të motivuara shoqërore.

Në programet që janë të dedikuara për tërë familjen, që emetohen në shërbimet programore televizive në periudhën deri në ora 20:00 nuk lejohet përdorim i tepruar i shprehjeve dhe gjesteve të pahijshme.

## Neni 8

### **Format e sjelljes sugjестive të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë**

Me qëllim të mbrojtjes së të miturve, emetimi i programeve që përmbajnë përshkrime, skena dhe/ose pamje me sjellje të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë, që lehtë mund të emetohet, patjetër duhet që gjithmonë të arsyetohet në kontekst adekuat.

#### Neni 9

### **Programe me parashikues**

Programet kontaktuese, interaktive me fallxhorë (tarot, astrologjia, fallxhorë dhe metoda të ngjashme) që sugjerojnë drejtpërdrejtë ndryshime të sjelljes personale, patjetër duhet të shënohen si programe që nuk rekomandohen për persona nën moshën 18 vjeçare, respektivisht mund të emetohen vetëm në periudhën kohore prej ora 00:00 deri 05:00.

Kufizimi i periudhës së emetimit nuk ka të bëjë me shtojcat e horoskopit ditor, të klasifikuara si pjesë e programit me funksion argëtues.

#### Neni 10

### **Teknikat e hipnozës**

Gjatë emetimit të materialit audiovizuel që përmban teknika të hipnozës, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele duhet patjetër që të qasen me përgjegjësi të plotë me qëllim që të mos shkaktohen efekte negative te të miturit, respektivisht para kamerës nuk guxon që të tregohet person i cili hipnotizon me tërë procedurën e tij verbale.

Shërbimet programore televizive janë të obliguar që para fillimit dhe pas pauzave për reklamime në programet e atilla të publikojnë në ekran, kurse ofruesit e shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë në vend adekuat në katalog, paralajmërim se programi përmban teknika të hipnozës.

#### Neni 11

### **Epilepsia fotosenzitive**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele janë të obliguar që të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme që të mbrojnë shikuesit që vuajnë nga epilepsia fotosenzitive.

Shërbimet programore televizive janë të obliguar që para fillimit dhe pas pauzave për reklamime në programet e atilla të publikojnë në ekran, kurse ofruesit e shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë në vend adekuat në katalog, paralajmërim se në program ka ndriçim drithërues.

#### Neni 12

### **Lajmet e simuluara**

Lajmet e simuluara që janë pjesë e ndonjë programi argëtues, artistik, dokumentar ose program tjetër, ose publikohet ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele për programet e tij, nuk guxojnë që të pasqyrohen në atë mënyrë që do të nxisë shikuesit që të mendojnë se ajo që e shohin dhe dëgjojnë në fakt janë lajme ose informata për diçka që ka ndodhur realisht.

## **III. KATEGORIZIMI I PROGRAMEVE DHE PERIUDHAVE KOHORE**

#### Neni 13

### **Programe që i nënshtrohen kategorizimit**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele janë të obliguar që ta kategorizojnë programin e përgjithshëm që emetohet në shërbimet programore televizive ose që ofrohen në katalogun e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, me përjashtim të lajmeve dhe programeve informative.

## Neni 14

### Kriteret për kategorizimin e programeve

Redaktori, në bazë të vetëdijes së tij etike dhe përgjegjësisë redaktuese, duhet që me vëmendje të vlerësojë nëse në kontestin konkret programor është e domosdoshme të emetohen përmbajtje që janë potencialisht të dëmshme për personat e mitur.

Gjatë pasqyrit të përmbajtjes dhe gjatë kategorizimit të programeve, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale duhet të marrin parasysh këto kriteret:

- numri (shpeshtësia) dhe natyra e përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve me dhunë, erotikë, sjelljes seksuale të ndaluar me ligji, fjalim të pahijshëm (vulgar), format sugjестive të sjelljes që lehtë imitohen, ndërsa janë të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë, sjelljen ofenduese për dinjitetin njerëzor etj.
- laramania dhe detajet me të cilat krijohet brutaliteti i dukshëm dhe/ose vulgariteti i përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve;
- vlerësimi nëse përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës, erotikës, sjelljes seksuale të ndaluar me ligj, fjalimin e pahijshëm (vulgar), format sugjестive të sjelljes që lehtë imitohen, e që janë të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë, si dhe sjellje ofenduese për dinjitetin e njeriut, paraqesin elemente komplementare në formë dramatike, ose në kontekst të programit arsimor, dokumentar dhe/ose informativ;
- nëse dhuna sugjerohet si mënyrë e zgjidhjes së konflikteve;
- shpeshtia dhe kohëzgjatja e planeve të mëdha dhe/ose të përshkrimeve të detajuara verbale, grafike dhe/ose tekstuale, skena dhe/ose pamje të brutalitetit dhe të vulgares;
- efektet përcjellëse estetike: muzikë, maska, makijazh dhe elementet e tjera grafike, skenografike dhe/ose kostimografike që mund të shkaktojnë shqetësim ose të rrisin ndjenjën e frikës dhe nënçmimit të dinjitetit njerëzor;
- psikologjia pas karaktereve, si dhe problematika e konkluzioneve kontroverse nga aspektet ekstroverte dhe introverte të personazheve dhe motiveve të tyre për sjellje të dhunshme, që mund të ndikojnë në mënyrë sugjестive mbi personat e mitur;
- përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e të miturve të vendosur në situata brutale dhe/ose vulgare;
- regjistri dhe trajtimi skenarist i dhunës dhe erotikës; glorifikimi ose neutralizimi, të konstruara përmes përshkrimeve dhe përmes zhvillimit të skenave dhe/ose pamjeve të plota të brutalitetit dhe vulgaritetit;
- qasja e regjisorit dhe skenaristit ndaj temave kontroverse; nxitja e padurimit racor, fetar, etnik, gjinor ose në ndonjë bazë tjetër, narkomani, vetëvrasje, incest, pedofili, dhunim, delikte të gjakut, dhe forma të ngjashme të kërcënimeve dhe/ose pasojave nga tortura psikofizike.

## Neni 15

### Kategoritë e programeve

Programet që i nënshtrohen kategorizimit, klasifikohen në këto pesë kategori:

- Kategoria e parë – programe të dedikuara për tërë publikun;
- Kategoria e dytë – programe që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, për përcjelljen e të cilave rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit;
- Kategoria e tretë – programe që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 12 vjeçare, për përcjelljen e të cilave është e domosdoshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit;
- Kategoria e katërt – programe që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 16 vjeçare, për përcjelljen e të cilave është e domosdoshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit;
- Kategoria e pestë – programe që nuk janë adekuate për publikun nën moshën 18 vjeçare.

Neni 16  
**Periudhat kohore për kategoritë e programeve**

Varësisht nga përbërja e pritur e publikut, programet e kategorive mund të emetohen në këto periudha kohore;

- Kategoritë e parë dhe e dytë të programeve emetohen gjatë tërë ditës dhe natës;
- Kategoritë e tretë emetohet në periudhën prej ora 20:00 deri në orën 05:00;
- Kategoritë e katërt emetohet në periudhën prej ora 22:00 deri në orën 05:00;
- Kategoritë e pestë emetohet në periudhën prej ora 00:00 deri në orën 05:00;

Neni 17  
**Përshkrimi i kategorive programore**

Kategoritë e programeve audiovizuale, të përcaktuara në nenin 15 të kësaj Rregullore përcaktohen sipas këtyre përshkrimeve:

- (1) **Kategoritë e parë – programe të dedikuara për tërë publikun.** Programe që mund të emetohen gjatë tërë ditës dhe natës dhe që mund ti përcjellë publiku më i gjerë, përfshirë edhe fëmijët e moshës parashkollore. Përdorimi i fjalorit të pahijshëm (vulgar) duhet të vihet në nivelin sa më të ulët të mundshëm. Paraqitja lakuriq e trupit të njeriut është i lejuar vetëm në aspekt neutral natyror, jashtë çfarëdo konteksti erotik. Nuk rekomandohet paraqitja e armëve të vërteta. Është e arsyeshme që përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me akte të dhunës të kufizohen vetëm në kërcënime të patheksuara pa çfarëdo shprehje verbale dhe/ose mizorie psikofizike në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Ndalohet paraqitja e narkomanisë, alkoolizmit, dhe sjelljeve të ngjashme devijuese. Skenat e frikës duhet që mirë të planifikohen me moshën e shikuesve më të rinj.
- (2) **Kategoritë e dytë – programe që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, për përcjelljen e të cilëve rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.** Mund të emetohen gjatë tërë një dite dhe nate, me rekomandim që të shikohen në mbikëqyrje të prindit ose kujdestarit. Mund të përfshihen tema më serioze: Sjellje devijuese, dhunë familjare, racizëm etj, mirëpo programet në asnjë rast nuk guxojnë që të nxisin dhe të përfshijnë çfarëdo afirmimi të sjelljeve devijuese ose të sjelljes së ofenduese për dinjitetin e njeriut. Nuk lejohet përdorimi i potencuar tepërt i fjalëve të pahijshme (vulgare). Paraqitja neutrale, e natyreshme e trupit lakuriq të njeriut, mirëpo pa kurrfarë konteksti vulgar seksual. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me erotikë duhet patjetër të jenë jashtëzakonisht të rralla dhe të patheksuara, diskrete dhe pa aluzione vulgare. Lejohet paraqitja e matur e dhunës, por pa detaje të mizorisë, të arsyeshme sipas skenarit, pa u potencuar prania e armëve të vërteta ose të teknikave të rrezikshme për konfrontim ndër njerëzor.
- (3) **Kategoritë e tretë – programe që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 12 vjeçare, për përcjelljen e të cilëve rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.** Programet, skenari i të cilëve përmban përshkrime, skena dhe/ose pamje të dhunës psikofizike sistematike ose të shpeshta, që mund të shqetësojnë personat e mitur. Përpunimi i temave serioze është e pranueshme, por duhet të jetë adekuate për moshën e përcaktuar të publikut. Lejohet përdorimi i fjalorit të pahijshëm, vulgar dhe brutalitetit, por duhet patjetër të jetë në masë të matur dhe të jetë e arsyeshme me funksionin e domosdoshëm të kontekstit dramatik ose atë informativ – dokumentar të programit. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me dhunë dhe erotikë, dhe lidhja eventuale e ndërsjellë në mes të këtyre dy faktorëve në zhvillimin e narratives, nuk duhet të potencojnë lëndimet fizike dhe/ose pasojat psikofizike të shkeljeve, e as të fokusohen në detaje të pahijshme fizike. Nuk duhet tu

jepet rëndësi e tepruar armëve dhe teknikave të konfrontimit ndër njerëzor që lehtë mund të imitohen, me potencial të rrezikshëm, që të ndikojnë në mënyrë sugjестive mbi pjesët psikologjike më pak stabil dhe mbi ato që janë të dijshëm emocionalisht. Pasqyrimi i narkomanisë është i lejueshëm mirëpo pa përpunim të detajuar të fazave të aktit të kategorizimit të personazheve dhe në mënyrë komplementare të tërësisë së llojeve të ndryshme të programit artistik, arsimor, informativ dhe/ose dokumentar. Paralajmërimet për programet e këtilla nuk guxojnë që të jenë të përbërë nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të shqetësojnë personat e mitur.

- (4) **Kategoria e katërt – programe që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 16 vjeçare, për përcjelljen e të cilave është e domosdoshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.** Programet, skenari i të cilëve përmban përshkrime, skena dhe/ose pamje të dhunës psikofizike sistematike ose të shpeshta, që mund të shqetësojnë personat e mitur. Nuk ka kufizime për temat. Lejohet përdorimi i shpeshtë i fjalorit të pahijshëm, mirëpo rëndë pranohet përdorimi i tepërt i shprehjeve ekstreme vulgare. Pasqyrimi i erotikës dhe marrëdhënieve seksuale është e lejueshme, mirëpo pa detaje eksplicite pornografike. Është e domosdoshme që të krijohen me kujdes konteksti për shprehje verbale dhe gjestikulative që kanë aluzion të fortë seksual dhe mund ta ofendojnë dinjitetin njerëzor. Pasqyrimi i narkomanisë është i lejueshëm mirëpo pa përpunim të detajuar të fazave të aktit të (keq)përdorimit të drogës, me balancimin e potencimit të pasojave dhe në funksion të kategorizimit të personazheve, në mënyrë komplementare të tërësisë së llojeve të ndryshme të programit artistik, arsimor, informativ dhe/ose dokumentar. Janë të pranueshme përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës dhe pasojat e dhunës, mirëpo jo edhe tregime me sadizëm, ose çfarëdo tjetër shprehje jonjerëzore dhe të maltretimimit të njerëzve dhe kafshëve. Paralajmërimet për programet e këtilla nuk guxojnë që të jenë të përbërë nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të shqetësojnë personat e mitur.
- (5) **Kategoria e pestë – programe që nuk janë adekuate për publikun nën moshën 18 vjeçare.** Tolerohen pasqyrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës dhe pasojat e dhunës, si dhe tregimet e marrëdhënieve erotike. Respektohet e drejta autonome dhe vetëdija e personit të rritur që të vendos gjatë përzgjedhjes së llojit dhe kategorisë që dëshiron që ta përcjell. Emetimi i pornografisë dhe sadizmit është i ndaluar dhe në asnjë rast nuk guxon që të vihet në korrelacion me këtë kategori të programeve. Në këtë kategori të programeve nuk ka kufizime në lidhje me temat, ndërsa rastet e vetme të kufizimit janë në lidhje me mënyrën e përpunimit të tyre.

## Neni 18

### **Renditja e programeve që mund të dëmtojnë personat e mitur në skemën programore**

Gjatë planifikimit të emetimit të programeve që mund të ndikojnë dëmshëm në zhvillimin personave të mitur, radiodifuzerët televiziv janë të obliguar që të marrin parasysh këto kritere:

- natyrën e përmbajtjes që mund të ketë ndikim negativ mbi personat e mitur;
- funksionin mediatik dhe zhanrin e programit konkret;
- numrin dhe moshën e personave të mitur që me siguri do ta përcjellin programin, duke pasur parasysh ditët e punës, vikendet dhe festat;
- pritjet e publikut në drejtim të përmbajtjes së programit në kohë konkrete gjatë ditës ose në një ditë konkrete.

## **IV. PARALAJMËRIMI AKUSTIK DHE SHENJAT VIZUALE - SINJALIZIMI PARALAJMËRUES**

### Neni 19

#### **Programe në të cilat aplikohet sinjalizimi paralajmërues**

Sinjalizimi paralajmërues detyrimisht aplikohet para fillimit dhe gjatë emetimit të programeve të shërbimeve televizive programore dhe në vend adekuat deri te programet që janë në katalogun e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë edhe atë:

- në të gjitha llojet e programit artistik, dhe
- në ato lloje të programeve me funksion informativ, arsimor ose argëtues, cilat do qoftë si tërësi ose përmes pjesëve të tyre, mund të ndikojnë dëmshëm te personat e mitur.

### Neni 20

#### **Mënyra e aplikimit të sinjalizimit paralajmërues**

Para fillimit të programeve televizive të përfshira me nenin 19 të kësaj Rregullore, detyrimisht emetohet sinjal paralajmërues që përshtatet me kategorinë e programit që është kombinim i shenjës vizuale, tekstuale, verbale dhe paralajmërimit akustik, që zgjatë së paku 10 sekonda, dhe përfshinë së pak 1/4 të pjesës së dukshme të ekranit.

Gjatë programeve televizive të përfshira me nenin 19 të Kësaj Rregullore, vazhdimisht emetohet vetëm shenja vizuale e sinjalit paralajmërues, që aplikohet me dimensione 1/32 të kënd të pjesës së dukshme të ekranit. Përrjashtim janë shenjat vizuale për programet televizive me teknika hipnotike dhe me dritë drithëruese, që aplikohen në ekran pas çdo pauze për reklamim.








Në vend adekuat te programet e përfshira me neni 19 të kësaj Rregullore, që janë në katalogun e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, detyrimisht aplikohet vetëm shenja vizuale, që përshtatet me kategorinë e programit.





Neni 21

**Pamja dhe përmbajtja e sinjalizimit paralajmërues**

Sinjalizimi paralajmërues që aplikohet para ose gjatë programeve nga ana e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale, duket kështu:

Shenjat vizuale	Sinjalet paralajmëruese
	 <p><b>цела публика</b></p> <p>Programe të kategorisë së parë të dedikuara për tërë publikun.</p>
	<p>Programe të kategorisë së dytë që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 8 vjeçare. Është e domosdoshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.</p>
	 <p>Programe të kategorisë së tretë që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 12 vjeçare. Është e domosdoshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.</p>
	 <p>Programe të kategorisë së katërt që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 16 vjeçare. Është e domosdoshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.</p>

	 <p>Programe të kategorisë së pestë që nuk janë adekuate për publikun nën moshën 18 vjeçare.</p>
<p>Programe me teknika hipnotike</p>	<p><b>Paralajmërim:</b> Programi përmban teknika hipnotike</p>
<p>Programe me dritë pulsuese</p>	<p><b>Paralajmërim:</b> Programe përmban dritë pulsuese që mund ti dëmtojë shikuesit që vuajnë nga epilepsia fotosenzitive</p>

#### Neni 22

#### Publikimet e programeve

Publikimet (paralajmërimet promovuese) për programet e radiodifuzerëve nuk guxojnë që të përmbajnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të dëmtojnë personat e mitur.

Publikimet nga paragrafi 1 i këtij neni detyrimisht duhet të jenë të shënuara me shenjën vizuale që e sinjalizon kategorinë e programit që paralajmërohet.

Publikimet për programet e kategorisë së pestë nuk guxojnë që të emetohet para orës 22:00.

### V. PËRMBAJTJET E LAJMEVE DHE PROGRAMET INFORMATIVE

#### Neni 23

#### Vlerësimi redaktues për domosdoshmërinë e detajeve

Kur lajmet dhe programet informative përfshijnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të ndikojnë dëmshëm mbi personat e mitur, aryseshmëria e emetimit të tyre patjetër duhet të bazohet në vlerësimin e redaksisë përgjegjëse për domosdoshmërinë e detajeve në materialin e atillë.

Publikimi i shtojcave në shërbimet televizive programore që ndërmjetësojnë për përshkrime, skena dhe/ose pamje të dhunës, materialit audiovizuel që mund ta ofendojë ose nënçmojë dinjitetin e njeriut, shtojca tjera, përmbajtja e të cilave mundet seriozisht ta cenojë zhvillimin fizik, psikik dhe/ose moral të personave të mitur, duhet patjetër të jetë në periudha kohore të skemës programore kur pritët që të miturit nuk e përcjellin programin.

Përgjegjësia profesionale e gazetarit nënkupton se edhe viktimat e dhunës duhet të trajtohen me respekt maksimal, ndërsa për shkak të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor trupat e tyre nuk duhet të tregohen në kuadër në plan të plotë, përveç në raste të jashtëzakonshme kur ajo është e pashmangshme për shkak të tërësisë së materialit informativ.

Gjatë publikimit të përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve që përdoren si argumente gjyqësore, përgjegjësia mediatike e ngarkon redaktorin e programit që me

vëmendje të vlerësojë nëse është e domosdoshme që kapacitet informativ i materialit të këtillë të përfshihet në tërësinë e programit të emetuar.

Neni 24  
**Komenti paralajmërues**

Nëse shtojcat ose pjesët përbërëse të shtojcave në lajme dhe në programet informative përfshijnë përmbajtje që mund të shqetësojnë personat e mitur, radiodifuzerët televiziv janë të obliguar që ti paralajmërojnë me komente paralajmëruese nga udhëheqësi.

Kjo qasje në një mënyrë nuk nënkupton restriktion të temave dhe ngjarjeve për të cilat mund të raportohet, mirëpo emetimi patjetër duhet të jetë i përcjell me komentim gazetaresk dhe/ose komentim profesional që do të mundësojë objektivitet të perspektivës informative.

Neni 25  
**Të miturit - kryerës ose viktima të veprave penale**

Nëse në lajme raportohet për persona të mitur që janë kryerës, dëshmitar ose viktima të dhunës seksuale ose veprave tjera penale, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale duhet të jenë të kujdesshëm që të mos publikojnë përshkrime, detaje, fotografi ose çfarëdo informata që mund të direkt ose indirekt të potencojnë identitetin e tyre.

**VI. OBLIGIMET E VEÇANTA PËR SHËRBIMET  
MEDIATIKE AUDIOVIZUELE ME KËRKESË**

Neni 26  
**Masat teknike për mbrojtjen e personave të mitur**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë janë të obliguar që të sigurojnë masa teknike me të cilat do tu pamundësohet personave të mitur qasje deri te përmbajtjet që mund t'i dëmtojnë.

Masat teknike nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jenë:

- kode për identifikim personal (PIN kode) me të cilat ofruesi i shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë me të cilën mund ta kontrollojë moshën e shfrytëzuesit para se ti mundësojë qasje deri te përmbajtjet e koduara, të kategorizuara dhe shënuara sipas dispozitave të kësaj Rregullore;
- filtrimi i përmbajtjeve të kategorizuara nga ana e ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë dhe të shënuara sipas dispozitave të kësaj Rregullore;
- zbatimi i sistemeve të pavarura për filtrim që e analizojnë programin, e njohin dhe përjashtojnë përmbajtjen e dëmshme në bazë të kategorive që i definojnë prindi/kujdestari;
- zbatimi i softuerëve tjerë me të cilët ju mundësohet prindërve/kujdestarëve që të bllokojnë qasjen e personave të mitur deri te përmbajtjet që mund ti dëmtojnë.

Neni 27

**Prezantimi dhe shënimi i programeve që mund ti dëmtojnë të miturit**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë janë të obliguar që përmbajtjet e marra nga shërbimet programore televizive nga Republika e Maqedonisë dhe përmbajtjet e tjera që janë të kapshme në katalog sipas kërkesës, që mund të ndikojnë dëmshëm mbi zhvillimin e personave të mitur, ti shënojnë me sinjalizim paralajmërues gjatë çdo theksimi në katalogun e programeve, dhe në publikimet për programet.

Informatat për kategorinë e pestë të programeve mund të prezantohen vetëm si pjesë e shërbimit që është e gatshme për pagesë, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për parapagesë ose pagesë pas çdo shikimi në veçanti.

**VII. DISPOZITAT PERFUNDIMTARE**

Neni 28

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore pushon vlefshmëria e Rregullores për mbrojtjen e publikut të mitur të programeve që mund të ndikojnë dëmshëm mbi zhvillimin e tyre fizik, psikik dhe moral ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 21/07).

Neni 29

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë duhet të harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e kësaj Rregullore në afat prej 2 (dy) muaj nga dita e hyrjes në fuqi.

Neni 30

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuale**

**Kryetar i Këshillit**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Nr. 01-5777/1  
21.11. 2014  
S h k u p